

28372; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Two More Killed Albanian Found in Dobratin Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 23.9.1998, FDH-29569.

### Islam (Ali) Rekalio

(2.06.1975, shqiptar nga Dobratini/Dobrotin, komuna e Podujevës/Podujevo, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

### Selim (Sabedin) Rekalio

(10.02.1976, shqiptar nga Dobratini/Dobrotin, komuna e Podujevës/Podujevo, pjesëtar i UÇK-së)

Islami dhe Selimi kanë qenë kushërinj. Në mëngjesin e datës **15.09.1998**, kur forcat serbe e nisën granatimin e fshatit **Dobratin/Dobrotin** [Podujevë/Podujevo], Selimi gjendej te Islami. Kur ushtarët serbë iu afruan shtëpive, rreth 400 njerëz me traktorë dhe automjete u nisën në drejtim të pyllit. Në mesin e tyre gjendeshin edhe Islami dhe Selimi. Derisa civilët po largoheshin nga fshati, pjesëtarët e UÇK-së shtënin nga kodra e afërme në drejtim të forcave serbe. Civilët i braktisën traktorët dhe automjetet, duke vazhduar të iknin më këmbë dhe përmes të shtënave në drejtim të fshatit Potok. Pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, babai i Islamit e kishte gjetur trupat e pajetë të të birit dhe të Selimit në pyll, jo larg shtëpisë. Një ditë më vonë [24.09.1998], ata u varrosën të nesërmen në varrezat e fshatit Dobratin/Dobrotin.

**Burimet:** deklarata A.R, FDH-35227; deklarata I.M, FDH-11752; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Two More Killed Albanians Found in Dobratin Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 23.09.1998, FDH-29569; TMK, *Regjistri...*, FDH-13257.

### Haki (Brahim) Rekalio

(10.07.1964, shqiptar nga Dobratini/Dobrotin, komuna e Podujevës/Podujevo, punëtor ndërtimtarie, dy fëmijë)

Hakio punonte në ndërmarrjen ndërtimore *Ramiz Sadiku* në Prishtinë/Priština. Në mëngjesin e datës **15.09.1998**, ai gjendej në shtëpi, kur forcat serbe kishin hyrë në fshatin **Dobratin/Dobrotin** [Podujevo/Podujevë]. Fshatarët kishin filluar të iknin në drejtim të fshatit Kaçandoll/Kaçandol. Hakio vendosi bashkëshorten, dy fëmijët e

tij dhe nënën në traktorin e një fqinji, kurse ai ndenji, duke thënë se do të nisej më vonë. Këtu familjarët për herë të fundit e kishin parë atë të gjallë. Në datën 19.09.1998, kushërinjtë e Hakiut, Aliu dhe Nexhmiu, e gjetën trupin e masakruar të Hakiut afër shkollës fillore. Po në atë ditë, atë e varrosën në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, në fund të muajit qershor të vitit 1999, trupi i Hakiut është zhvarrosur, me qëllim identifikimin e tij dhe më pas është rivarrosur në të njëjtin vend.

**Burimet:** deklarata R.R, FDH-11730; deklarata A.R, FDH-35227; *More Victims Identified After Serbs Leave Some of Villages of Podujeva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 18.09.1998, FDH-29565.

### Maksut (Islam) Rekalio

(1934, shqiptar nga Dobratini/Dobrotin, komuna e Podujevës/Podujevo, bujk, katër fëmijë)

Në datën 15.09.1998, Maksuti e kishte braktisur fshatin **[Dobratin/Dobrotin]** me kolonën e njerëzve, që me traktorë dhe automjete përpiqeshin për tu larguar nga fshati, para se të arrinin policia dhe ushtria serbe. Ai me familje u nis me traktor në drejtim të pyllit të afërm. Në një çast, gjatë shkëmbimit të zjarrit në mes të UÇK-së dhe forcave serbe, të gjithë fshatarët, përfshirë edhe Maksutin, i braktisën traktorët dhe u nisën më këmbë në pyll. Më vonë, Maksuti vendosi të kthehej që ta merrte traktorin. Aty e takoi të vëllain Aliun, i cili i ndihmoi për ta hequr rimorkion nga traktori. Në atë çast [**15.09.1998**], erdhi një xhip me ushtarë serbë, të cilët menjëherë filluan të shtënin ndaj Maksutit dhe Aliut. Maksutin e plagosën rëndë dhe pas disa minutash ai ndërroi jetë, derisa Aliu arriti të ikte me vrap. Pas tërheqjes së forcave serbe, Aliu me një kushërinj u kthyen dhe e morën trupin e pajetë të Maksutit. Po atë ditë, atë e varrosën në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata A.R, FDH-35227; *Tensions Run High in Podujeva Area, Many Missing and Feared Dead*, pasqyra e lajmeve, KIC, 17.09.1998, FDH-29564; *More Victims Identified After Serbs Leave Some of Villages of Podujeva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 18.09.1998, FDH-29565.